

onoren. Në muajin shtator të vitit 1998 dhe për shkak të drojës nga forcat serbe, që ishin të stacionuara në afërsi të fshatit, Ramizi me familjarët e vet kaluan për një kohë në Shqipëri. Qëndruan rreth një muaji në fshatin Nikoliq. Pastaj, vendosën që të ktheheshin në shtëpi. Herët në mëngjes, më **22.10.1998**, nga ora 2:00, ata u nisën më këmbë për të kaluar kufirin. Në afërsi të postbllokut kuftar **Goden**, i cili gjendet në afërsi të fshatit të tyre, pjesëtarët e Brigadës së Motorizuar të 549 të UJ-së shtënë mbi ta. Që të gjithë anëtarë të familjes Sylmetaj u shtrin menjëherë në tokë. Fadili filloi të bërtiste në serbisht që të mos gjuanin sepse grupi përbëhej prej civilëve. Të shtënat pushuan. Një ushtar i ftoi që të afroreshin, çfarë ata edhe e bënë. Por, sapo u quan në këmbë, ushtarët sërish hapën zjarr mbi ta. I qëlluan për vdekje Ramizin me djemtë Muharremin dhe Mazllumin, ndërkaq Leonoren vetëm e plagosën. Kur të shtënat më në fund pushuan, të mbijetuarit e morën Leonoren dhe e çuan në Gërçinë/Grçina, ndërkaq trupat e pajetë të Ramizit, Muharremit dhe Mazllumit kanë mbetur në vendin ku ata u vranë. Po atë ditë, por më vonë, Fadili me disa të afërm të tij i kanë bartur trupat e të vrarëve në spitalin e Gjakovës/Đakovica. Një ditë më vonë, më 23.10.1998, Leonora ka dhënë shpirt nga plagët vdekjeprurëse. Po atë ditë, familjarët i kanë varrosur Leonoren, Ramizin, Muharremin dhe Mazllumin në varrezat lokale.

**Burimet:** deklarata S.S, FDH-16411; KMDLJN, *Buletini*, num.9, tetor-dhjetor 1998, 146, FDH-23857.

### Ilir (Muharrem) Dervishaj

(28.09.1967, shqiptar nga Korenica, komuna e Djakovës/Đakovica, bujk, dy fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Iliri merrej me kultivimin e tokës. Kohë pas kohe punonte edhe në ndërtimtari. U inkadrua në radhët e UÇK-së në fillim të vitit 1998. Nuk vinte në shtëpi nga 3 apo 4 ditë. Në datën 1.08.1998, ai u nis në *Mullirin e Hasit* për të bluar grurë, por rrugës e sipër hasi në policinë serbe. Ata e urdhëruan që të shkonte dhe t'i fshinte arat

me grurë në pronësi serbe. Iliri refuzoi ta bënte këtë dhe ata e rrahën keq. Shërohej nga lëndime të shkaktuara gjatë keqtrajtimeve të tij fizik, duke ndenjur në krevat për disa ditë. Pastaj, u kthye në njësitin e vet. Bashkëshortja e tij, Zoja, më **24.10.1998**, kishte mësuar nga vjehri se Ilirin e kishin vrarë në afërsi të bregores së quajtur *Bo-kat e Devës/Devin kamenjar* [**Devë/Deva**]. Trupi i Ilirit ka mbetur në vendin e vrasjes deri më 27.10.1998, kur i ati Muharremi, pasi që e korruptoi një polic serb, e mori lejen për ta varrosur të birin në fshat. Po atë ditë, varrimi i Ilirit u bë në varrezat lokale në Korenicë/Korenica.

**Burimet:** deklarata Z.D, FDH-29786; J. Martin-sen, *Regjistri..*, FDH-26092.

### Xhemajl (Kamer) Zekolli

(14.04.1972, shqiptar nga Drenoci/Drenovac, komuna e Klinës/Klina, bujk, pjesëtar i UÇK-së)

Familja e Xhemajlit i numëronte 24 anëtarë. Ai ka qenë pjesëtar i UÇK-së. Familjarët i kanë humbur të gjitha kontaktet me të që nga muaji qershor i vitit 1998. Më vonë, vëllezërit e tij kanë mësuar se ai kishte gjetur vdekjen më **24.10.1998**, në afërsi të shkollës fillore në fshatin **Kralan/Kraljane**. Ishte në shoqëri me Shaip Rexhepin dhe dy pjesëtarë të tjerë të UÇK-së. Donin të hynin në shkollën lokale për të marr disa dokumente dhe në atë çast forcat serbe hapën zjarr në drejtim të tyre. Xhemajlin e qëlluan për vdekje, përderisa shoqëruesit e tij shpëtuan. Për shkak të përlëshjes së armatosur në mes të dy forcave ndërluftuese, trupi i Xhemajlit ka mbetur në vendin e vdekjes. Më vonë, ai u zhdruk në rrethana të pasqaruara. Xhemajli ende konsiderohet zyrtarisht i zhdrukur dhe rasti i tij është evidentuar nga KNKK-ja, në lëndën që e mban numrin rendor BLG-803750-01.

**Burimet:** deklarata N.Z, FDH-19309; KNKK, *Persona të zhdukur..*, FDH-9795.

### Muhamet (Rrustem) Alijaj

(20.10.1962, shqiptar nga Gërgoci/Grgoc, komuna e Gjakovës/Đakovica, afarist, pesë fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Muhameti ka qenë pronar i ndërmarrjes